



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

KOMISIONI PËR PUNËN, ÇËSHTJET SOCIALE DHE SHËNDETËSISË

Tiranë, më 20. 5. 2019

Dokument parlamentar

(Komision për dhënie mendimi)

R A P O R T

MBI

PROJEKTLIGJIN

**“PËR TRAJTIMIN FINANCIAR, SUPLEMENTAR, TË PUNONJËSVE QË
KANË PUNUAR NË MINIERA, NË NËNTOKË, TË PUNONJËSVE TË
INDUSTRIË SË NAFTËS E TË GAZIT DHE TË PUNONJËSVE QË KANË
PUNUAR NË METALURGJI”**

I. Hyrje

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësisë, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 20.05.2019, mori në shqyrtim me procedurë të përshpejtuar projektligjin “Për trajtimin financiar, suplementar, të punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”, nismë e Këshillit të Ministrave.

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë e shqyrtoi këtë projektligj në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, bazuar në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar, mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishin të pranishëm z. Elton Haxhi, Zv. Ministër i Financave dhe Ekonomisë, z. Bashkim Sala, këshilltar në ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, z. Astrit Hado Drejtor Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH) dhe z. Ali Emiri, zëvendës drejtor pranë (ISSH).

Baza ligjore Kushtetuese

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me nenet 78, 83, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ai bazohet në nenet

78, 83 pika 1, të Kushtetutës dhe miratimi i tij i nënshtrohet rregullit të përgjithshëm për sa i përket shumicës.

Projektligji “Për trajtimin financiar, suplementar, të punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”, ka për qëllim të japë një kontribut, në kuadër të rolit social të shtetit duke mundësuar trajtim financiar më të plotë dhe mbulimin me përfitime, përpara kohës së mbushjes së moshës për pension, si dhe përfitime shtesë, mbi ato që akordohen nga ligji nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për tre kategori mjaft të veçanta punonjësish që kanë punuar në punë të vështira konkretisht në miniera, në nëntokë, në industrinë e naftës, si dhe në punë me një shkallë vështirësie shumë të lartë në metalurgji.

Përfitues, sipas këtij ligji, janë pensionistet që kanë përfutuar pension sipas ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, apo sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe pensionistët që kanë përfutuar pension sipas ligjit nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, punonjësit që kanë kryer procese pune në miniera, në nëntokë dhe që do plotësojnë kushtet e këtij ligji në vitet e ardhshme, punonjësit që kanë punuar në industrinë e naftës e të gazit dhe personeli inxhiniero-teknik, që ka punuar në ndërmarrjet e sistemit të naftës, si shpim-kërkim, shpim-shfrytëzim, prodhim, sizmikë, gjeofizikë kantieriale, përpunim dhe transport me naftësjellës dhe gazsjellës si dhe punonjësit që kanë punuar në metalurgji, në profesione, punë shumë të vështira, shkrirje etj.

Nëpërmjet ndryshimeve të propozuara, përcaktohen qartësisht periudhat e punës në atë industri që njihen për efekt të llogaritjes së përfitimeve të parakohshme, apo të përfitimeve shtesë. Gjithashtu, saktësohen dispozitat lidhur me llojet e përfitimeve, ribalancohen të drejtat si dhe harmonizohen kostot.

Projektligji ka në themel të tij vendosjen e një skeme të njëjtë përfitimi suplementar që konsiston në tre elementë, të cilët janë:

- pension për shkak të profesionit (llojit të punës);
- shtesë mbi pensionin e pleqërisë;
- shtesë mbi pensionin e invaliditetit.

Përfituesit, të cilët kanë, apo do të plotësojnë kushtet për të përfutuar pension pleqërie, kanë të drejtën e përfitimit të shtesës mbi pension kur kanë këto periudha sigurimi në profesion respektivisht:

- Për punonjësit e nëntokës 12.5 vjet;
- Për punonjësit e industrisë së naftës e të gazit për disa kategori profesioni dhe pune (vështirësi) për burrat 15 vjet dhe për gratë 12.5 vjet dhe për disa kategori të tjera pune dhe profesioni (vështirësi) për burrat 20 vjet dhe për gratë 15 vjet;
- Për punonjësit e metalurgjisë: burrat 20 vjet, gratë 15 vjet.
- Gjithashtu, punonjësit e këtyre industrive kanë të drejtën e trajtimit me pension për shkak të profesionit deri në 15 vite përpara moshës së pensionit nga skema e detyrueshme.

Masa e përfitimit mujor të pensionit për shkak të profesionit (llojit të punës), për të gjithë personat që plotësojnë kushtet e sipërcituara lidhur me periudhën e sigurimi në profesion,

Ilogaritet rast pas rasti sipas përcaktimeve në dispozitat e ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Masa e përfitimit të shtesës mbi pensionin e pleqërisë do të jetë për punonjësit e nëntokës, 1% të masës së pensionit të pleqërisë; për punonjësit e industrinë së naftës e të gazit dhe punonjësit e metalurgjisë, 0,6 % të masës së pensionit të pleqërisë. Këtë shtesë mbi pension, e përfitojnë të gjithë personat që kanë jo më pak se 6 vite në profesionet dhe punët e përcaktuara sipas këtij projektligji.

Masa e përfitimit të shtesës për pension invaliditeti do të jetë në masën 1% për çdo vit vjetërsie pune në miniera, në nëntokë, industrinë e naftës dhe në metalurgji.

Përfitimi i kësaj skeme do të bëhet me aplikim/kërkesë nga përfituesi përkundrejt gjithë dokumentacionit të nevojshme të përcaktuar në aktet nënligjore të ligjit.

Duhet theksuar fakti se skema e sigurimeve shoqërore të detyrueshme mbështetet në parimin kontributiv, në parimin e solidaritetit të brezave, lidhur me krijimin e të drejtave dhe mbulimin e pagesave, në një formulë pensioni që bazohet në vitet e sigurimit dhe në madhësinë e kontributeve të paguara, e barabartë për të gjithë dhe pavarësisht nga veprimtaria ekonomike. Në këto kushte, kjo skemë nuk mund të mbulojë përfitime të veçanta apo shtesë, të ndryshme nga parimet e përgjithshme. Çdo përfitim i veçantë mbetet të mbulohet me kontribute shtesë ose nga taksat e përgjithshme.

Sa më sipër, në kushtet kur sistemi i pensioneve dhe çdo përfitim social i kësaj natyre kërkon mbulim me kontribute dhe duke njohur faktin se ish-punonjësit e nëntokës në trajtimin financiar të veçantë apo mbetur të papunë dhe pa mbështetje sociale, me kushte të plotësuar, nuk kane periudha të mbuluara me kontribute shtesë për përfitime të parakohshme, skema përcakton vendosjen edhe të një kontributi shtesë, prej 5%, që paguhet nga punëmarrësit dhe punëdhënësit aktualë, financime buxhetore për mbulimin e përfitimeve aktuale si dhe pjesë të efektit financiar që nuk mbulohet nga kontributi shtesë.

II. Shqyrtimi i projektligjit në komision.

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, gjatë shqyrtimit të projektligjit, shpjegoi se projektligji ka në fokus punonjësit që kanë punuar në miniera, në nëntokë, në industrinë e naftës e të gazit dhe ato që kanë punuar në metalurgji. Ky projektligj nuk prek skemën e pensioneve dhe trajtimin e përcaktuar në ligjin nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë” të ndryshuar dhe ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Në rastin konkret për të gjithë përfituesit aktualë, që janë pensioniste apo përfitues të pensioneve të parakohshme kërkesa nuk ka natyrën e pensionit, por të një trajtimi financiar shtesë, i cili do të përballohet nga buxheti i shtetit. Ky trajtim financiar shtesë për këtë kategori punësh që konsiderohen punë të vështira mundëson njëkohësisht edhe unifikimin e trajtimit ndërmjet tyre.

Anëtarët e tjerë të komisionit, theksuan rëndësinë e këtij projektligji në kuadër të përmirësimit të kujdesit shëndetësor dhe morën pjesë aktive në rishikimin e dispozitave të tij, duke synuar saktësimin dhe përmirësimin e mëtejshëm.

Në përfundim, Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, duke ritheksuar dhe vlerësuar se miratimi i këtij projektligji është i nevojshëm dhe sjell elementë të shumtë të shtuar, në kuadër të rolit social të shtetit duke mundësuar trajtim financiar më të plotë dhe mbulimin me përfitime, përpara kohës së mbushjes së moshës për pension, si dhe përfitime shtesë, mbi ato që akordohen nga ligji nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për Sigurimet

Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për tre kategori mjaft të veçanta punonjësish që kanë punuar në punë të vështira konkretisht në miniera, në nëntokë, në industrinë e naftës, si dhe në punë me një shkallë vështirësie shumë të lartë në metalurgji. Me votat pro të të gjithë të pranishmëve e miratoi projektligjin, në parim, nën për nën dhe në tërësi me ndryshimet e mëposhtme.

1. Neni 1, riformulohet me këtë përmbajtje:

“Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është trajtimi financiar, i punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji, përveç trajtimit të përcaktuar në ligjin nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë” të ndryshuar dhe ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.”

2. Në nenin 2 bëhen këto ndryshime:

- paragrafi i parë riformulohet me këtë përmbajtje:

“Përfitues, sipas këtij ligji, janë personat në profesione e punë, në miniera, në nëntokë, në industrinë e naftës e të gazit dhe në metalurgji që iu njihet vjetërsia në punë dhe periudha e sigurimit sipas përcaktimeve të nenit 3 të këtij ligji e që njëkohësisht plotësojnë edhe kushtet e tjera të përcaktuara në këtë ligj, si më poshtë vijon:”

- në shkronjën “a”, pas përcaktimit “në Republikën Popullore të Shqipërisë” shtohet përcaktimi “të ndryshuar”, si dhe pas përcaktimit “dhe” shtohet përcaktimi “ligjit”.

3. Në nenin 3 bëhen këto ndryshime:

- Përpara çdo paragrafi vendosen numra (gjithsej 6 pika);
- Pikat 3 dhe 4, riformulohen me përmbajtjen e mëposhtme:

“3. Për efekt përfitimi sipas këtij ligji, proceset e punës në miniera, në nëntokë, në industrinë e naftës dhe në metalurgji, pas datës 30.9.1993, do të njihen, nëse janë kryer dhe dokumentuar sipas kriterëve të përcaktuara në vendimin nr. 526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave, “Për ndarjen e punëve në kategori, për efekt pensioni”, të ndryshuar, pavarësisht nëse të punësuarit kanë kryer aktivitet ekonomik në subjekte me kapital plotësisht ose pjesërisht shtetëror si dhe në subjekte private.

“4. Emërtimet e profesioneve dhe punëve si pasojë e ndryshimeve të teknologjisë, organizimit e të pronësisë së kapitaleve, të cilat nuk përputhen apo parashikohen në vendimin nr. 526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave, “Për ndarjen e punëve në kategori, për efekt pensioni”, të ndryshuar, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”

- Në pikën 5, përcaktimi “në pikën 3” zëvendësohet me përcaktimin “në nenin 3” dhe referenca ligjore “sipas nenit 6” zëvendësohet me referencën “sipas nenit 8”.

- Në fund të pikës 6, përcaktimi “për këtë ligj” zëvendësohet me përcaktimin “për qëllime të këtij ligji”.

4. Në nenin 5 bëhen këto ndryshime:

- Paragrafi i parë riformulohet me këtë përmbajtje :

“Personat e përcaktuar në nenin 2 të këtij ligji, kanë të drejtën e përfitimeve të pensionit për shkak të profesionit apo të shtesës mbi pension kur plotësojnë kushtet, si më poshtë vijon:”

- Në pikën 1, shkronja “c”, paragrafi i fundit riformulohet me këtë përmbajtje:

“Kur nuk plotësohen kushtet sipas shkronjës “b” të këtij neni, periudha e punës sipas shkronjës “b” i shtohet periudhës së punës sipas përcaktimeve në shkronjën “c” të këtij neni. Në këtë rast, kushtet e përfitimit janë ato sipas shkronjës “c”, nënpika “i” deri “iii”.”

5. Në nenin 6 bëhen këto ndryshime:

- Titulli i nenit 6 të riformulohet “Masa e përfitimit të shtesës mbi pensionin e pleqërisë dhe të shtesës për pension invaliditeti”.
- Në pikën 1, termi “Masa e përfitimit”, të zëvendësohet me termin “Masa e përfitimit të shtesës mbi pensionin e pleqërisë”,
- Në shkronjën “a” të pikës 1, termi “ish-punonjës” të zëvendësohet me termin “Punonjësit” dhe pas përcaktimit “të cilët kanë përfituar”, të shtohet përcaktimi “pension pleqërie”.
- Në pikën 2 përcaktimi “Masa e përfitimit për invalidët” të zëvendësohet me përcaktimin “Masa e përfitimit të shtesës për pension invaliditeti”. Gjithashtu për unifikim termash termi “Përfituesit” të zëvendësohet me termin “Punonjësit”. Pas përcaktimit “të cilët kanë përfituar”, të shtohet përcaktimi “pension pleqërie” dhe përcaktimi “ kanë të drejtë e përfitimit të shtesës” të zëvendësohet me përcaktimin “përfitojnë shtesë”.

6. Në nenin 8 të vendoset numeracioni përpara tre paragrafëve të fundit respektivisht 3, 4 dhe 5.

KRYETAR DHE RELATOR

Enver Roshi